REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr 3482/2 prot.

Gramsh, më 30/10/2026

P/VENDIM

Nr.____ Datë ____.____.2026

PËR
DHËNIE SHPËRBLIMI NGA FONDI REZERVË PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE PËR KURIM

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës datë 30.10.2026 pasi mori në shqyrtim ,kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga **z. Qemal Kume** për miratimin e përdorimit të pjesshëm nga fondi rezerve të planit të buxhetit të vitit 2026, mbështetur në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" i ndryshuar, në ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, vendimi nr. 105 datë 29.12.2025 "Për buxhetin e vitit 2026" i ndryshuar, si dhe ligjin nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore " neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 gërma "b", neni 54 gërma "dh"

VENDOSI :

1 - Dhënien e masës së shpërblimit në masën **50.000 lekë** (pesëdhjetë mijë) lekë nga fondi rezervë për **z. Qemal Kume** për të përballuar shpenzimet për kurim.

2 - Përndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës.

3 - Për sa më sipër të bëhen ndryshimet në buxhet si më poshtë:

Enti Qevesises	Min. Linjes	Kodi. Institucioni	Ermërtimi Institucionit	Kapitulli	Program	Llog. Ekono	TDO	Debiti
			Pakësohet					
114	00	2114001	Bashkia Gramsh	05	04980	6090000	0810	50.000
			Shtohet					
114	00	2114001	Bashkia Gramsh	05	01110	6060000	0810	50.000

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI KËSHILLIT

XHULIA GJINI

KRYETARI I KËSHILLIT

Luljeta Dollani